

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJI

Nr.faq/Dr.str. 91
Datë/Datum 27.06.2024

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 27.06.2024

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 27.06.2024, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 1239, të datës 10.06.2024, paraqitur nga Drejtoria e Financave dhe Buxhetit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetit për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (b), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, shkronja (c), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për aprovimin e Kornizë Afatmesme Buxhetore Komunale për 2025 - 2027

1. Për aprovimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale për vitet 2025 - 2027, në Komunën e Fushë-Kosovës, me kufijtë e caktuar buxhetor si vijon:
 - 1.1 Për vitin 2025 buxheti i komunës është në shumë prej: 16,747,838.00€;
 - 1.2 Për vitin 2026 buxheti i komunës është në shumë prej: 17,592.179.00€ dhe
 - 1.3 Për vitin 2027 buxheti i komunës është në shumë prej: 18,456,253.00€;
2. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera, për zbatimin e këtij vendimi për Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale për vitet 2025 - 2027, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB, Drejtorive të Komunës dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
 KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
 DIREKTORIA E ADMINISTRIMIT - DIRECTION FOR ADMINISTRATION

Nr./No. 1335
 Datë/Date 27.06.2024
 KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
 REPUBLIC OF KOSOVA
 KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/
 MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE



DATË/A:	27.06.2024
PËR/ZA/TO:	Z. Hekuran Murati /Minister i F.P.dhe T. Z. Salvador Elmazi –Drejtor i Departamentit të Buxhetit në M.F.P.T
C.c	
PËRMES	
NGA/OD/FROM:	Z.Burim Berisha /Kryetar i Komunes së Fushë-Kosovës
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2025-2027

Të nderuar ,

Përmes kësaj shkrese Ju dërgojmë Kornizen Afatmesme Buxhetore Komunale, për vitet 2025-2027

Me respekt,



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE



Datë: 10.06.2024

**KORNIZA AFATMESME BUXHETORE KOMUNALE
(KABK)
2025 – 2027**

1. Qëllimi

Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale (KABK) 2025-2027 paraqet dokumentin kryesor mbi bazën e të cilit do të hartohet Buxheti Vjetor për vitin 2025. Qëllimi kryesor i KABK-së është që të ofrojë një analizë të bazuar të mjedisit makroekonomik në vend, për të vendosur kështu bazën për planifikimet buxhetore për vitet që vijnë në përputhje me prioritetet strategjike të Qeverisë.

Kjo kornizë e buxhetit për vitet 2025-2027 bazohet në KASH 2025-2027 që është aprovuar nga Qeveria e Kosovës. Korniza është hartuar në bazë të Strategjisë Komunale për Zhvillimin Ekonomik 2016-2020, Qarkores Buxhetore 2025/01 të lëshuar nga MFPT, Qarkores së Brendshme Buxhetore Komunale 2025/01, LMFP të nenit 20 etj. Marrë parasysh që jemi në proces të regjistrimit të popullsisë, më lejoni t'ju njoftoj se kufijtë buxhetorë të lëshuar përmes kësaj Qarkore mund të pësojnë ndryshime. Komuna (DBF) ka për detyrë ta dorëzojë këtë kornizë tek Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, të aprovuar nga Kuvendi Komunal, deri më **30 Qershor të vitit aktual**.

2. Objektivat e Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale

Korniza Afatmesme Buxhetore për periudhën 2025–2027 planifikohet në bazë të Buxhetit, i cili bazohet në “Buxhetin e programeve” dhe është i bazuar në objektivat e Komunës. KAB Komunale 2025–2027 është krijuar në përputhje me udhëzimet e Qarkores Buxhetore nr. 2025/01, e cila sfond të vetin dhe kontekst ka prioritet e programeve dhe kursimet e shpenzimeve.

Objektivat e Komunës:

- Mbrojtja, përmirësimi i ambientit dhe infrastrukturës së qytetit;
- Përfshirja e tërësishme në arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm, si dhe ngritja e nivelit të arsimit;
- Zhvillimi i fushës së shëndetësisë dhe mirëqenies sociale;
- Zhvillimi i fushës së kulturës, rinisë dhe sportit;
- Promovimi dhe përkrahja e bizneseve të vogla dhe të mesme;
- Përkrahja e të rinjve dhe ulja e papunësisë;
- Subvencionimet në bujqësi;
- Përkrahja e OJQ-ve në përgjithësi, e në veçanti organizatat e të rinjve.

Me qëllim të përmbushjes së kërkesës së Qeverisë për përgatitjen e buxhetit në kohën e duhur, thelbësore është që të gjitha drejtoritë të veprojnë në pajtim me afatet kohore dhe kërkesat e specifikuar në këtë Kornizë. KAB Komunale paraqet një mjet të procesit për zhvillimin e buxhetit, që bën ndërlidhjen e planeve, politikave dhe resurseve në dispozicion me prioritetet e komunës, me qëllim që të demonstrojë qëndrueshmërinë e programeve komunale gjatë periudhës së ardhshme trevjeçare, si dhe projekteve të cilat ndihmojnë në realizimin e prioriteteve të Qeverisë, të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim 2016-2021. KAB duhet të përcaktojë këto fusha përkatëse për tri vitet vijuese fiskale:

- Vlerësimin e të hyrave nga të gjitha burimet;
- Vlerësimet e hershme (nëpër kategoritë ekonomike);
- Programi i investimeve publike.

Në KAB janë paraqitur tabelat që prezantojnë shpërndarjen e grantit, projeksionin e të hyrave të drejtorive nga të gjitha burimet, investimet kapitale, ndarja e buxhetit sipas programeve dhe nënprogrameve, si dhe masat dhe rekomandimet tjera, etj.

3. Shpërndarja e Grandeve

Në tabelat e poshtë cekura (1,2) kemi të dhënat e shpërndarjes së grandeve për komunën tonë, të aprovuara nga Komisioni i Grandeve, që është mbajtur në muajin prill të këtij viti, nga Qarkorja Buxhetore 2025/1, nr. pr. 1259/2024 të dates 15.05.2024 të lëshuar nga MFP dhe T.

➤ Granti i përgjithshëm

Granti i Përgjithshëm për komuna për vitin 2025 është aprovuar nga Komisioni i Granteve në shumë prej 307.5 milionë euro.

Kjo ndarje bazohet në formulën e përcaktuar në nenin 24 të LFPL. Sipas këtij neni, 10% e të hyrave totale të buxhetuara të Qeverisë qendrore ju ndahen komunave, Me qëllim të nivelizimit të kapacitetit të ulët të të hyrave vetanake të komunave më të vogla, bazuar në LFPL, secila komunë do të pranojë për çdo vit një shumë të përgjithshme fikse prej 140,000 euro, duke zbritur nga 1 euro për kokë banori ose 0 euro për komunat me popullsi të barabartë ose më të madhe se 140,000 banorë. Pas kësaj, shpërndarja e bërë nëpër komuna bazohet në formulën për alokimin e grantit të përgjithshëm në komuna sipas LFPL: (i) numri i popullsisë llogaritet me tetëdhjetë e nëntë përqind (89%); (ii) përmasat gjeografike të komunës me gjashtë përqind (6%); (iii) numri i popullsisë pakicë në komunë me tre përqind (3%); (iv) komunat ku shumica e popullsisë së të cilave përbëhet nga pakicat me dy përqind (2%).

➤ Granti Specifik për Arsim sipas LFPL

Granti Specifik për Arsim para universitar sipas LFPL, bazohet në sistem të hapur të financimit, duke marrë parasysh kriteret në formulën e arsimit para universitar të MASHTI për vitin 2025-2027.

Grantin specifik për arsim para universitar për vitin 2025 është aprovuar në shumë prej 249.1 milion euro si vijon:

- Paga dhe shtesa në shumë prej 233.8 milion euro,
- Mallra dhe shërbime në shumë prej 13.1 milion euro,
- Investime kapitale në shumë prej 2.2 milion euro.

Formula trajton nivelin e arsimit parafillor, fillor dhe të mesëm, duke marrë për bazë këto kritere:

- a) Numri i nxënësve të regjistruar për vitin 2023/2024;
- b) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin fillor dhe të mesëm për nxënësit shumicë 1:21.3
- c) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin fillor dhe të mesëm për nxënësit pakicë 1:14.2;
- d) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin parashkollor 1:12;
- e) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin e mesëm profesional për nxënësit shumicë 1:17.2, dhe për nxënësit pakicë 1:11.5;
- f) Raporti nxënës-mësimdhënës për zonat malore 1:14.2;
- g) Kalkulimi për stafin mësimdhënës të gjuhës angleze për klasën I dhe II;
- h) Kalkulimi për stafin teknik administrativ për 630 nxënës 1 staf në arsimin parafillor dhe fillor;
- i) Kalkulimi për stafin teknik administrativ për 470 nxënës 1 staf në arsimin e mesëm
- j) Kalkulimi për stafin ndihmës për 170 nxënës 1 staf (pastrues) si dhe 1 staf për shkollë (roje);
- k) Kalkulimi i pagave dhe shtesave është bazuar në Ligjin për Paga në sektorin Publik;
- l) Shërbimi profesional Pedagogjik/Psikologjik;
- m) Koordinatorët e cilësisë;
- n) Mallrat dhe shërbimet janë kalkuluar sipas kriterit për nxënës (23 euro për nxënës shumicë dhe 25 euro për nxënës pakicë) dhe për shkollë (1,500 euro për shkollë parafillore dhe fillore dhe 3,250 euro për shkollë të mesme);
- o) Kapitalet janë kalkuluar sipas kriterit 7 euro për nxënës;
- p) Asistent për fëmijë me nevoja të veçanta;
- q) Praktika profesionale

- r) Kosto e pagesës së procedurave për validim dhe akreditim për shkollat e mesme të larta profesionale (8 Shkolla);
- s) Këshilltarë të karrierës me bazë në shkollë klasa 6 deri 9;
- t) Specialist të IT-së.

Sipas MASHTI-të është raportuar numri për 4,180 nxënës më pak në arsim para universitar krahasuar me vitin paraprak.

Me Qarkoren Buxhetore Komunale 2025/02 do të bëhet rishikimi dhe harmonizimi i stafit në sektorin e arsimit para-universitar.

➤ Granti specifik për Shëndetësi Primare

Granti Specifik për shëndetësi primare sipas LFPL, bazohet në sistem të hapur të financimit, duke marrë parasysh kriteret në formulën e shëndetësisë primare të MSH për vitin 2025-2027.

Granti specifik për shëndetësi primare për vitin 2025 është aprovuar në shumë prej 83 milion euro, si në vijim:


- I. Kategorinë paga dhe shtesa në sektorin e shëndetësisë në shumë prej 60.3 milion euro,
- II. Koston për vizitë dhe shërbim në shume prej 14.23 milion euro.
- III. Vizitat në shtëpi për shtatzëna dhe fëmijë në shumë prej 2.13 milion euro (politik në vazhdimësi),
- IV. Vizitat e kujdesit paliativ në shumë prej 2.1 milion euro (politik në vazhdimësi),
- V. Shpenzime tjera operative në mallra dhe shërbime në shumë prej 2.1 milion euro
- VI. Shpenzime komunale në shumë prej 2.1 milion euro.

Me Qarkoren Buxhetore Komunale 2025/02 do të bëhet rishikimi dhe harmonizimi i stafit në sektorin e shëndetësisë primare.

Tabela 1. Shpërndarja e Granteve dhe të Hyrave Komunale 2025-2027

Organizata buxhetore	Buxheti	Plani i buxhetit për vitet		
	2024	2025	2026	2027
Granti i Përgjithëshem	5,480,065.00	5,916,282.00	6,257,124.00	6,604,182.00
Granti i Arsimit	5,278,623.00	5,530,790.00	5,696,714.00	5,867,615.00
Granti i Shëndetësisë	1,812,205.00	1,841,091.00	1,928,727.00	2,020,534.00
Të Hyrat Vetanake	3,714,607.00	3,459,675.00	3,709,614.00	3,963,922.00
Huamarrja në Shëndetësi		-		
TOTALI	16,285,500.00	16,747,838.00	17,592,179.00	18,456,253.00

% e Rritjes së Granteve, THV dhe Buxhetit për vitin 2025



4. Projektionet e të Hyrave Vetanake Komunale për vitin 2025 dhe parashikimet 2025-2027

Projektionet e të hyrave vetanake komunale në shkallë vendi për vitin 2025 bazuar, në vlerësimet makro-fiskale, janë në shumë prej 115 milion euro. Këto të hyra i shtohen financimit komunal krahas granteve komunale. Të hyrat komunale të Komunës sonë realizohen në bazë të Rregullores për Tarifa dhe Ngarkesa Komunale, Rregullores për Tatimin në Pronë si dhe dispozitave tjera ligjore, (Ligji për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal nr.03-L-049) të cilat përcaktojnë llojet e ndryshme të të hyrave komunale, me të cilat Komuna ka të drejtë të caktojë dhe inkasojë të hyrat komunale:

Tabela 2. Parashikimi i të hyrave buxhetore komunale 2025-2027

Burimet e të Hyrave	Buxheti		
	2025	2026	projeksionet 2027
Grantet qeveritare	13,288,163.00	13,882,565.00	14,492,331.00
Totali i të H.Vetanake	3,459,675.00	3,709,614.00	3,963,922.00
Taksa për regjistrimin e automjeteve	160,000.00	178,323.00	179,000.00
Taksa Komunale për leje ndërtimi	1,263,094.00	1,300,000.00	1,357,719.00
Taksa për Regjistrimin e Trashëgimisë-bartja e pronës	90,000.00	92,000.00	93,500.00
Taksë Admini.(Certifik.lind.,kurorëzim., vdekjes,shtet., etj)	54,000.00	55,000.00	56,200.00
Taksa Administrative -Fletëkërkesat	10,000.00	11,000.00	13,000.00
Taksa per legalizimin e objekteve	30,000.00	35,000.00	45,000.00
Taksa për leje rrënimi	17,000.00	18,000.00	19,000.00
Taksa ndrrimi i destinimit te tokës	140,000.00	142,000.00	145,000.00
Taksa për ushtrimin e veprimtarisë -biznese	-	-	-
Leje mjedisore Komunale	140,000.00	143,000.00	145,000.00
Regjistrimi i pengut - hipoteka	29,000.00	32,000.00	34,000.00
Licencimet tjera - zgjatja e orarit të punës	1,000.00	1,000.00	1,500.00
Inspektimet (ushqimore, higjieniko - sanitare, veterinë, etj)	8,000.00	9,400.00	9,800.00
Të hyrat nga shërbimet e ndryshme (qiraja, etj.)	12,000.00	13,500.00	14,800.00
Të hyrat nga shër. e ndryshme (Kopja e pl.,)	73,000.00	75,000.00	76,000.00
Të hyrat nga tatimi në pronë	1,042,889.00	1,144,460.00	1,227,434.00
Të hyrat nga tatimi në tokë	230,192.00	269,231.00	325,769.00
Të hyrat nga arsimit	90,000.00	110,000.00	130,000.00
Të hyrat nga shëndetësia	39,000.00	40,500.00	50,500.00
Të tjera -	30,500.00	40,200.00	40,700.00
TOTALI ;	16,747,838.00	17,592,179.00	18,456,253.00

5. Buxhetimi i programeve

Do të bëhet sipas programeve dhe nënprogrameve të Administratës, të Arsimit dhe të Shëndetësisë. Nga drejtorët do të kërkohet të përcaktojnë se në cilat programe do të bëhet shpërndarja e fondeve, si dhe shumën që do të vihet në dispozicion me buxhet për secilin program. Transferet në mes të programeve do të kufizohen gjatë vitit buxhetor 2025, ndërsa Drejtorët e Programeve do të jenë përgjegjës dhe të autorizuar për bërjen e shpenzimeve nga programet e tyre.

Buxhetet Komunale 2025 - 2027 do të përgatiten nëpër të gjitha kategoritë ekonomike për shpenzimet e buxhetuara, të definuara sipas Thesarit, e që janë: "Paga e mëditje", "Mallra e shërbime", "Shërbime komunale", "Subvencione e transfere" dhe "Shpenzime kapitale".

6. Shfrytëzimi i Vlerësimeve të Hershme

Ky buxhet aktual nënkupton që kostoja e vlerësuar e programeve të vazhdueshme komunale do të publikohet për buxhetin në dy vitet vijuese (këto dy vite referohen si vlerësime të hershme). Edhe pse publikohet buxheti trevjeçar, vetëm fondet për vitin aktual buxhetor do të ndahen në bazë të parasë së gatshme, shih tabelën nr. 3,4,5.

Tabela 3. Planifikimi i Buxhetit për vitin 2025

Kodet e Program.	Programet/nën-programet	Stafi 2025	Paga e Mëditje	Mallra e Shërbime	Shpenzime Komunale	Subvencione e Transfere	Investime Kapitale	Totali
16002	Zyra e Kryetarit	18	165,480.51	20,000.00		30,000.00		215,480.51
16302	Administrata dhe Personeli	23	171,448.32	20,000.00			90,000.00	281,448.32
16422	Regjistrimi Civil	8	50,241.77	5,000.00				55,241.77
16502	Çështjet Gjinore	4	16,384.96	2,000.00		5,000.00		23,384.96
16603	Inspektimet	13	85,765.91	13,000.00				98,765.91
16902	Zyra e Kuvendit	27	232,250.04	15,000.00				247,250.04
17502	Buxhet dhe Financa	12	106,171.40	9,000.00			260,000.00	375,171.40
18162	Shërbimet Publike	14	90,868.14	944,820.00	184,600.00	56,000.00	790,000.00	2,066,288.14
18210	Shërbimet e Zjarrfikësve	5	38,840.50	4,000.00				42,840.50
19710	Z.K.K	7	35,682.90	5,670.00		3,000.00		44,352.90
47042	Bujqësia	12	82,943.26	93,260.00		215,000.00		391,203.26
48002	Zhvillimi Ekonomik	12	72,275.70	15,000.00		60,000.00	145,000.00	292,275.70
65010	Kadastra dhe Gjeodezi	12	81,470.86	7,000.00				88,470.86

16542	Integri. Evropiane ,Teknologji Inovacion	6	37,332.70	6,500.00			61,000.00	104,832.70
18002	Infrastruktura Rrugore	9	58,911.82	10,000.00			1,880,000.00	1,948,911.82
66015	Planifikimi Urban dhe Mjedisi	14	116,562.14	10,000.00				126,562.14
73011	Administrata e Shëndetësisë	7	44,202.77	135,325.00	60,000.00	374,000.00	405,000.00	1,018,527.77
73150	Shërbimet e Shëndetësisë Primare	226	1,332,725.19	250,000.00				1,582,725.19
75506	Shërbimet Sociale	15	76,408.46	20,000.00	7,000.00	5,000.00		108,408.46
85002	K.R.dhe Sportet	15	97,543.45	73,000.00		159,675.00	610,000.00	940,218.45
92010	Administrata e Arsimit	8	52,886.64	130,000.00		391,000.00	540,000.00	1,113,886.64
92230	Arsimi Parashkollor (çerdhet)	70	373,739.61	51,860.00	20,500.00			446,099.61
93030	Arsimi Fillor	711	4,084,512.76	230,433.00	51,700.00			4,366,645.76
94230	Arsimi i Mesem	93	687,545.19	55,100.00	26,200.00			768,845.19
TOTALI		1,341	8,192,195.00	2,125,968.00	350,000.00	1,298,675.00	4,781,000.00	16,747,838.00

Shpërndarja e Buxhetit për vitin 2025 në mënyrë grafike




Tabela 4. Planifikimi i Buxhetit për vitin 2026

Kodet e Program.	Programet/nën-programet	Stafi 2026	Paga e Mëditje	Mallra e Shërbime	Shpenzime Komunale	Subvencion e e Transfere	Investime Kapitale	Totali
16002	Zyra e Kryetarit	18	173,028.73	25,000.00		34,000.00		232,028.73
16302	Administrata dhe Personeli	24	182,449.00	25,000.00				207,449.00
16422	Regjistrimi Civil	8	56,241.77	5,000.00				61,241.77
16502	Çështjet Gjinore	4	16,384.96	2,000.00		5,500.00		23,884.96
16603	Inspektimet	13	104,226.63	15,000.00				119,226.63
16902	Zyra e Kuvendit	27	232,250.04	15,000.00				247,250.04

17502	Buxhet dhe Financa	12	110,171.40	12,000.00			500,000.00	622,171.40
18162	Sherbimet Publike	15	108,166.14	969,820.00	194,600.00	66,000.00	904,389.00	2,242,975.14
18210	Sherbimet e Zjarrfikësve	5	40,840.50	5,000.00				45,840.50
19710	Z.K.K	7	47,682.90	6,670.00		4,000.00		58,352.90
47042	Bujqësia	12	98,113.88	93,260.00		230,000.00		421,373.88
48002	Zhvillimi Ekonomik	13	88,275.70	15,000.00		67,000.00	245,000.000	415,275.70
65010	Kadastër dhe Gjeodezi	13	88,470.86	8,000.00				96,470.86
16542	Integri. Evropiane ,Teknologji Inovacion	6	38,332.70	7,500.00				45,832.70
18002	Infrastruktura Rrugore	10	60,911.82	12,000.00			1,270,000.000	1,342,911.82
66015	Planifikimi Urban dhe Mjedesi	14	166,562.14	12,000.00				178,562.14
73011	Administrata e Shëndetësisë	7	52,202.77	125,325.00	60,000.00	385,000.00	440,830.00	1,063,357.77
73150	Shërbimet e Shëndetësisë Primare	230	1,400,725.19	450,000.00				1,850,725.19
75506	Shërbimet Sociale	15	84,408.46	21,000.00	7,000.00	10,000.00		122,408.46
85002	K.R.dhe Sportet	15	105,543.45	74,000.00		175,675.00	1,062,220.00	1,417,438.45
92010	Administrata e Arsimit	8	60,886.64	132,000.00		395,000.00	310,000.00	897,886.64
92230	Arsimi Parashkollor (çerdhet)	72	407,739.61	52,840.00	20,500.00			481,079.61
93030	Arsimi Fillor	715	4,304,456.52	250,433.00	61,700.00			4,616,589.52
94230	Arsimi i Mesem	95	697,545.19	58,100.00	26,200.00			781,845.19
TOTALI		1,358	8,725,617.00	2,391,948.00	370,000.00	1,372,175.00	4,732,439.00	17,592,179

Shpërndarja e Buxhetit për vitin 2026 në mënyrë grafike





Tabela 5. Planifikimi i Buxhetit për vitin 2027

Kodet e Program.	Programet/ nën programet	Stafi 2027	Paga e Mëditje	Mallra e Shërbime	Shpenzime Komunale	Subvencione e Transfere	Investime Kapitale	Totali
16002	Zyra e Kryetarit	19	181,028.73	35,000.00		40,000.00		256,028.73
16302	Administrata dhe Personeli	25	194,449.00	35,000.00				229,449.00
16422	Regjistrimi civil	9	66,241.77	5,500.00				71,741.77
16502	Çështjet Gjinore	5	26,384.96	2,500.00		5,500.00		34,384.96
16603	Inspektimet	14	114,226.63	18,500.00				132,726.63
16902	Zyra e Kuvendit	27	232,250.04	17,000.00				249,250.04

17502	Buxhet dhe Financa	13	120,171.40	6,000.00			500,000.00	626,171.40
18162	Sherbimet Publike	16	118,166.14	980,820.00	200,600.00	68,000.00	952,428.00	2,320,014.14
18210	Sherbimet e Zjarrfikësve	6	50,840.50	5,000.00				55,840.50
19710	Z.K.K	8	57,682.90	6,670.00		6,500.00		70,852.90
47042	Bujqësia	13	108,113.88	97,260.00		240,000.00		445,373.88
48002	Zhvillimi Ekonomik	14	108,275.70	16,000.00		68,000.00	545,000.000	737,275.70
65010	Kadastër dhe Gjeodezi	14	98,470.86	9,000.00				107,470.86
16542	Integri. Evropiane ,Teknologji Inovacion	7	40,332.70	7,500.00				47,832.70
18002	Infrastruktura Rrugore	11	60,911.82	13,000.00			1,205,319.000	1,279,230.82
66015	Planifikimi Urban dhe Mjedisi	15	166,562.14	12,500.00				179,062.14
73011	Administrata e Shëndetësisë	8	52,202.77	137,325.00	60,000.00	400,000.00	600,000.00	1,249,527.77
73150	Shërbimet e Shëndetësisë Primare	240	1,692,725.19	345,000.00				2,037,725.19
75506	Shërbimet Sociale	16	84,408.46	21,500.00	7,000.00	14,000.00		126,908.46
85002	K.R.dhe Sportet	16	105,543.45	75,000.00		177,675.00	955,500.00	1,313,718.45
92010	Administrata e Arsimit	9	64,052.64	141,000.00		400,000.00	390,000.00	995,052.64
92230	Arsimi Parashkollor (çerdhet)	80	423,739.61	53,840.00	20,500.00			498,079.61
93030	Arsimi Fillor	730	4,304,456.52	245,433.00	61,700.00			4,611,589.52
94230	Arsimi i Mesem	97	697,545.19	57,200.00	26,200.00			780,945.19
TOTALI		1,412	9,168,783.00	2,343,548.00	376,000.00	1,419,675.00	5,148,247.00	18,456,253.00

Shpërndarja e Buxhetit për vitin 2027 në mënyr grafike



8. Programi i Investimeve (Kapitale) Publike – PIP

Në tabelën nr.6 janë paraparë investimet kapitale për periudhën tre vjeçare. Këto propozime janë vlerësime të hershme të cilat mund të ndryshohen nga kërkesat e qytetarëve, brenda kufijve buxhetor. Nga drejtoritë do të kërkohet të përgatisin analizat e PIP për të gjitha projektet e investimeve publike. Propozimet që nuk përmbajnë analizat e PIP nuk do të merren parasysh për financim. Propozimet e PIP do të përfshijnë si ato për shqyrtim të financimit nga BKK dhe të Hyrat Vetanake ashtu edhe ato që propozohen për financim nga donatorët. Ato duhet të përfshijnë projekte që do të niseshin në vitet 2025, 2026 dhe 2027, jo vetëm projektet që fillojnë në vitin 2025.

Ne kërkojmë nga drejtorët e drejtorive që të fillojnë me përgatitjen e kërkesave të tyre për projektet kapitale, sa më herët që është e mundur, kjo do të ndihmonte në shmangien e vonesave pasuese! Propozimet e

projekteve që janë dorëzuar në procesin e PIP - it vitin e kaluar por që nuk janë financuar, mund të dorëzohen sërish.

Tabela 6. Programi Komunal i Investimeve Publike (PIP) 2025 – 2027

Nr	Kod. Fun.	K o p r.	Emri i Projektit	Plan i 2025 nga i cili:			Projeksi. 2026	Projeksi. 2027
				Kostoja totale	Transferet qeveritare	Të hyrat vetanake		
I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX
	SHPENZIMET KAPITALE TOTALE			4,781,000.00	2,620,000.00	2,161,000.00	4,732,439.00	5,148,247.00
	612163 - Administrata dhe Personeli							
	16302 - Administrata							
1	0133		Blerja e automjeteve (Kamion me korpë, cisternë për pastrim të rrugëve, kamion T5, skiper)	90,000.00	90,000.00			
	612163		Administrata dhe Personeli	61,000.00		61,000.00		
			16420 – Integritime, Teknologji dhe Inovacion			61,000.00		
2	0420		Salla e Inovacionit në Objektin Komunal			61,000.00		
	612175 - Buxhet dhe Financa			260,000.00	260,000.00		500,000.00	500,000.00
3	0112		Bashkëfinancimi i projekteve të ndryshme sipas prioritetit të Komunës, Impianti i ujërave të zeza, dhe projektet nga Donatorët dhe Ministrinë e Linjes.	260,000.00	260,000.00		500,000.00	500,000.00
	612480 – Zhvillimi Ekonomik			145,000.00		145,000.00	245,000	545,000.00
			48002-Zhvillimi Ekonomik Lokal			145,000.00		
4	0411		Tabela informuse -Promovimi i turizmit lokal	20,000.00		20,000.00	30,000.00	40,000.00
5	0411		Sistemi Solar në institucionet e - Administratës, QKMF-së, dhe Arsimit	125,000.00		125,000.00	165,000.00	450,000.00
6	0411		Ndërtimi i shkallëve në Pomozotin, Parku Rekreativ në pisha të Sllatinës së Vogël				50,000.00	55,000.00
	612180 - Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile, Emergjencia			790,000.00	260,000.00	530,000.00	904,389.00	952,428.00
			18162 – Infrastrukturë Publike		260,000.00	530,000.00		
7	0451		Ndërtimi i rrugëve bujqësore me zhavor, në fshatra	40,000.00		40,000.00	80,000.00	66,428.00
8	0451		Renovimi i tri objekteve banesore në Bresje – Fushë-Kosovë	150,000.00		150,000.00	180,000.00	200,000.00

9	0451	Ndërtimi i urave, shtratit të lumenjëve në fshatra	40,000.00		40,000.00	60,000.00	60,000.00
10	0451	Rregullimi i nënkalimit (urës në Vragoli) Rruga e Pejës-M9	50,000.00		50,000.00		
11	0451	Riparimi i rrugëve të asfaltuara nëpër vendbanime (qytet dhe fshatra)	230,000.00	230,000.00		219,389.00	250,000.00
12	0451	Vendosja e ndriçimit publik dhe mirëmbajtja e tërsishme -Kornizë	50,000.00		50,000.00	200,000.00	200,000.00
13	0451	Shenjzimi horizontal dhe vertikal i rrugëve në qytet dhe fshatra	30,000.00	30,000.00		45,000.00	46,000.00
14	0451	Ndërtimi i kanalizimeve dhe ujësjellësit: Harilaq, Grabovc.	200,000.00		200,000.00	70,000.00	80,000.00
15	0451	Vendosja e kamerave nëpër vendbanime ;F.Kosovë rr."Uglarit" lagja 28dh29, "Hamdi Grajqevci", Miradi e Epërme rr. UÇK , "Dëshmori ",M.Ultë,"rr.Batusë, B.Madhe rr."Nën-Hekurudhe",Lismir rr."Bardhit" ,Harilaq pas Goleshit ,S.Madhe rr."Xhamia",S.Vogel rr."Pishat", Grabovc rr."Rezistenca" etj..				50,000.00	50,000.00
18002-Infrastrukturë Rrugore			1,880,000.00	1,330,000.00	550,000.00	1,270,000.00	1,205,319.00
16	0451	Ndërtimi i parqeve, hapësirave të reja rekreative,dhe këndi i lojrave nëpër vendbanime, (qytet dhe fshatra)	110,000.00	110,000.00		100,000.00	100,000.00
17	0451	Mbjellja e pemëve dekorative, dhe vendosja e ulëseve dhe shportave nëpër vendbanime, (qytet dhe fshatra) .	10,000.00	10,000.00		50,000.00	200,000.00
18	0451	Ndërtimi dhe rregullimi i trotuareve nëpër vendbanime, (qytet dhe fshatra)	100,000.00	100,000.00		100,000.00	200,000.00
19	0451	Rregullimi në rrugën Dardania Fushë-Kosovë (trotuaret , ndriçimi, largimi i terrasave, sinjalizimi, infrastruktura elektrike) Faza e I	450,000.00	250,000.00	200,000.00	400,000.00	
20	0451	Rikonstruimi i rrugëve me: trotuare ,ndriçim, infrastruktura elektrike dhe e telefonisë, shtegu i bicikletave në rrugët: "Hajrullah Zymeri " , "Hamdi Grajqevci " , "Enver Maloku"	340,000.00	340,000.00			
21	0451	Rregullimi i hapësirave pranë rrugës UÇK në Bardh të Madh me: trotuare ,ndriçim, gjelbërim etj	200,000.00	200,000.00			

22	0451	Ndërtimi i rrethojave për siguri në komunikacion në fshatrat: Vrogoli dhe Sllatinë e Madhe-"Rruga e Pejës-M9"				40,000.00	50,000.00
23	0451	Asfaltimi në Fushë-Kosovë - Rruga "Eqrem Qabej-faza -I" me infrastrukturë përcjellëse (trotuaret, ndriçimi, kanalizimi)	150,000.00	150,000.00		200,000.00	300,000.00
24	0451	Asfaltimi në Fushë-Kosovë - Rruga "Amir Elmazi","Xheladin Idriz".	130,000.00	130,000.00			
25	0451	Asfaltimi në Nakaradë – Rugët: "Mirenët""Fehmi Lladrovci" dytësore-krah, ", "Avni Rrustemi- dytësore "	100,000.00	40,000.00	60,000.00		
26	0451	Asfaltimi në Fushë-Kosovë - Rugët: "Lagjia 28", "Lagjia 29" etj.	90,000.00		90,000.00		
27	0451	Asfaltimi në Graboc – Rugët: "12 Qershori - dytësore", "Rezistenca".	10,000.00		10,000.00	30,000.00	
28	0451	Asfaltimi në Bardh të Madh – Rugët: "Nënhekurudha"-dytësore , "UÇK Bardhi "	15,000.00		15,000.00	55,000.00	50,000.00
29	0451	Asfaltimi në Bardh të Vogël – Rugët: "Lisi", "Bardhi"..etj	10,000.00		10,000.00	30,000.00	20,000.00
30	0451	Asfaltimi në Sllatinë të Madhe - Rruga E Pejës-dytësore etj	15,000.00		15,000.00	40,000.00	20,000.00
31	0451	Asfaltimi në Sllatinë të Vogël - Rugët: "Tetori", "Shpati"etj	10,000.00		10,000.00	20,000.00	20,000.00
32	0451	Asfaltimi në Vragoli - Rrugët : "Mahalla e Larte", "9 Prilli", "Livadheve ", "Lidhja e Pejës etj	10,000.00		10,000.00	20,000.00	20,000.00
33	0451	Asfaltimi në Miradi të Epërme – Rugët: ", "Bregu I Madh" Lumi " "Gervalla" etj	10,000.00		10,000.00	30,000.00	35,000.00
34	0451	Asfaltimi në Harilaq – Rugët - "Otava", "Blinishta"	10,000.00		10,000.00	20,000.00	20,000.00
35	0451	Asfaltimi në Henc – Rugët: "Liçeni", "Abdyl Henci" etj	10,000.00		10,000.00	30,000.00	30,000.00
36		Asfaltimi në Lismir – Rugët: "Unaza Lot II", "Ymer Sfarqa", "Ejup Gashi"	70,000.00		70,000.00	20,000.00	70,319.00
37	0451	Asfaltimi në Kuzmin	10,000.00		10,000.00	20,000.00	20,000.00
38	0451	Asfaltimi në Pomozotin – Rugët: "Kroi-Dytësore " 1,2,3, etj	10,000.00		10,000.00	20,000.00	20,000.00

39	0451	Asfaltimi në Miradi të Poshtme- Rrugët: "Miradi", "Graçanka", "Blata", "Bardhosh Gërvalla", "Ylli i Dritës", "Përtej Lumit",	10,000.00		10,000.00	45,000.00	30,000.00
612730 - Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale			405,000.00	390,000.00	15,000.00	440,830.00	600,000.00
40	0760	Paisje shëndetësore -QKMF	150,000.00	150,000.00		200,000.00	300,000.00
41	0760	Blerja e kondicionerve për shëndetësi - QKMF,AMF,QMF.	40,000.00	40,000.00			
42	0760	Blerja e gjeneratorit -QKMF	15,000.00		15,000.00	50,000.00	
43	0760	Ndërtimi I QKMF-së - faza e II	200,000.00	200,000.00			
44	0760	Ndërtimi i shtëpisë për përkujdesjen e të moshuarve në Fushë-Kosovë				190,830	300,000.00
612850 - Kulturë, Rini dhe Sport			610,000.00	170,000.00	440,000.00	1,062,220.00	955,500.00
45	0820	Rregullimi dhe zgjerimi i stadiumit të qytetit - faza e II "Ekrem Grajqevci" Fushë-Kosovë	445,000.00	170,000.00	275,000.00	212,220.00	350,000.00
46	0820	Rregullimi i stadiumit në Sllatinë të Madhe	55,000.00		55,000.00		
47	0820	Rregullimi i stadiumit në Bardh të Madhe	55,000.00		55,000.00	50,000.00	
48	0820	Rregullimi i stadiumit në Miradi të Epërme	55,000.00		55,000.00	50,000.00	30,000.00
49	0820	Renovimi I fushave të futbollit me bari sintetik tek shkollat: "B. Curri" - Henc, "V. Frasheri"-Vragoli, "Z. Salihu" - Pomozotin, "Lismiri"-Lismir.				550,000.00	400,000.00
50	0820	Ndërtimi i qendrës multifunkionale me objektet përcjellëse Rr. "Nena Terez"				200,000.00	175,500.00
612920 - Arsimit dhe Shkencë			540,000.00	120,000.00	420,000.00	310,000.00	390,000.00
51	0980	Blerja e inventarit për shkolla	70,000.00		70,000.00	60,000.00	45,000.00
52	0980	Rregullimi I oborrit të shkollës fillore "Zenel Salihu" në Bardh të Madh	30,000.00	30,000.00			
53	0980	Renovimi i objekteve shkollore, shkolla fillore "Selman Riza".	90,000.00	90,000.00		50,000.00	45,000.00
54	0980	Ndërtimi i Çerdhës në Sllatinë të Madhe dhe Miradi e Epërme	350,000.00		350,000.00	200,000.00	300,000.00

9. Fazat e procesit buxhetor 2025 - 2027

Pjesa në vijim prezanton kalendarin kohor të buxhetit komunal dhe ofron një përmbledhje të hapave dhe veprimeve që kërkohen gjatë procesit buxhetor komunal 2025 – 2027.

Hapi 1: Shqyrtimi i prioriteteve nga drejtoritë komunale

Ky hap kërkon nga drejtoritë që të bëjnë shqyrtimin e çështjeve rreth politikave dhe prioriteteve në fushat e tyre të përgjegjësisë. Në pajtim me prioritetet e gjera të komunës (kur janë në dispozicion) secila drejtori duhet të ofrojë gjithashtu listën përmbledhëse të propozimeve të politikave të reja me prioritet që do të propozohen për procesin buxhetor komunal 2025 - 2027 (d.m.th. që pritet të fillojnë për çdo vit), bashkë me opsionet për kursimet e mundshme në programet e prioritetit të ulët dhe me performancë të dobët.

Shqyrtimi i prioriteteve do t'iu mundësojë drejtorive që të garojnë në procesin e përcaktimit të prioriteteve në një fazë të hershme të procesit për zhvillimin e buxhetit dhe para se të merren vendimet për kufijtë e fortë buxhetor. Nëse propozimi apo opsioni aprovohet (në parim) nga Bordi i Drejtorve gjatë këtij procesi fillestar të shqyrtimit të prioriteteve, drejtoria do të bëjë kërkesën më të hollësishme, si pjesë e materialit buxhetor, në fazat e mëvonshme të procesit buxhetor.

Hapi 2: Dorëzimi i buxhetit

Dorëzimet e materialeve buxhetore janë mjete përmes të cilave drejtoritë bëjnë prezantimin e vlerësimeve të tyre buxhetore dhe propozimeve të hollësishme të politikave të reja si dhe opsioneve për kursime në kontekst të strategjisë afatmesme fiskale (dhe në pajtim me kufijtë fillestar buxhetor). Dorëzimi buxhetor duhet të dizajnohet për të thjeshtësuar mbledhjen e informatave .Me shfrytëzimin e vlerësimeve të hershme, dhe duke njohur faktin që shumica e programeve komunale vazhdojnë nga një vit në tjetrin, në fokus të marrjes së vendimeve rreth buxhetit do të jenë propozimet për programet shpenzuese të reja dhe/apo plotësuese si dhe ato që u nënshtrohen kursimeve potenciale në kontekst të pozitës aktuale fiskale.

Hapi 3: Dëgjimet buxhetore

Kur të ketë kaluar afati kohor i specifikuar me Qarkoren Interne Buxhetore Komunale 1, 2, ZKF do të shqyrtojë buxhetet e propozuara që janë dorëzuar nga njësitë funksionale. Drejtoritë dhe sektorët do të mbajnë seanca dëgjimore me qëllim të shqyrtimit dhe të kuptuarit të buxheteve të propozuara, me qëllim të përpjekjes për zgjidhjen e çështjeve dhe shqetësimeve lidhur me buxhetet e propozuara, veçmas për sa i përket pajtueshmërisë së tyre me kufijtë fillestar specifik të drejtorive . Qytetarët do të njoftohen me kohë rreth dëgjimeve buxhetore (dy javë para mbajtjes) përmes shtypit ditor,web-faqes se Komunes ,mediave elektronike dhe njoftimeve publike.

Koha e mbajtjes së dëgjimeve buxhetore:

Dëgjimet buxhetore me qytetarë mbahen në sallën e Kuvendit të Komunës:

- 1. Më 05 Korrik 2024, ora 10:00**

2. Më 26 Korrik 2024, ora 10:00

3. Më 23 Gusht 2024, ora 10:00

Hapi 4: Shqyrtimi i buxhetit komunal

Kur Kryetari, së bashku me drejtorët e drejtorive, të ketë aprovuar buxhetin e propozuar komunal për tri vitet e ardhshme fiskale, përfshirë këtu dhe dokumentet përcjellëse ashtu si kërkohet nga MEF, atëherë Kryetari bën dorëzimin e dokumenteve të buxhetit të propozuar në KPF dhe në Kuvendin e Komunës. Dokumentacioni Përmbledhës i Buxhetit për publikim, shpërndarje dhe shfrytëzim nga ana e Kuvendit të Komunës, dhe opinionit publik gjithashtu, do të dorëzohet së bashku me dokumentacionin e detajuar të buxhetit. Kuvendi bën shqyrtimin e tyre në takimin e rregullt të radhës, apo në ndonjë takim special të ftuar më herët, me qëllim të shqyrtimit të atyre dokumenteve. Rekomandohet që Kuvendi i Komunës të organizojë takim të paralajmëruar në mënyrë adekuate, ku kërkohet nga opinionit publik, kontributi i tyre në lidhje me buxhetin, si dhe shqyrtimin dhe aprovimin e tij. Ky takim duhet të jetë i mbuluar nga mediat, buxheti publik të adresohet nga ZKF dhe Kryetari i Kuvendit të Komunës, ndërsa rekomandohet që të jetë ky një takim i hapur me publikun, në përputhje me Rregulloret.

10. Kalendari kohor

Organizatave buxhetore të nivelit lokal duhet t'i përmbahen këtij kalendari kohor në përgatitjen e propozim buxhetit:


- 30 qershor: Aprovimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale,
- 30 shtator: Aprovimi i propozim-buxhetit komunal për vitin 2025-2027 nga Kuvendi Komunal,
- 30 shtator: pas aprovimit të propozim-buxhetit nga Kuvendi Komunal, komunat janë të obliguara të dorëzojnë në Ministrinë e Financave, P.dhe T. dokumentet si në vijim:
- Shkresa përcjellëse bazuar në aprovimin e propozim-buxhetit nga Kuvendi Komunal (nënshkruar nga Kryetari i Komunës).
- Vendimi i Kuvendit Komunal mbi aprovimin e propozim-buxhetit komunal për vitin 2025-2027, përfshirë projektet kapitale shumëvjeçare.
- Tabelat e buxhetit komunal (BDMS-së dhe PIP):
- Tabela 4.1 - plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve për vitin 2025-2027 (kopje e shtypur prej SZHMB, vulosur si dhe nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe ZKF),
- Tabela 4.2 - financimi i projekteve kapitale për vitin 2025 dhe projekteve kapitale

shumëvjeçare për vitin 2026-2027 (shtypur nga sistemi PIP, vulosur si dhe nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe ZKF),

- Tabela 4.3 - plani afatmesëm i të hyrave totale të buxhetit komunal nga grantet qeveritare dhe të hyrat vetanake (shtypur nga SZHMB, vulosur si dhe nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe ZKF),
- Tabelat e Buxhetimit sipas performancës dhe
- Tabelat e Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjzinor.

Planifikuese e Buxhetit

Shqipe Islami



Drejtor i Drejtorisë së Financave

Ramadan Jashanica

